

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS –Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Have Haliti dhe Driton Muharremi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Rrezarta Lleshaj, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.G. nga..., tani me vendbanim në Beograd, për shkak të veprës penale, Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 135 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësve të akuzuarit S.G. av. Z.J. dhe av. D.V. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë PKR.nr. 392/2015 të datës 29.06.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, me datë 15.11.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

1.Me aprovimin ankesave të mbrojtësve të akuzuarit S.G. av. Z.J. dhe av. D.V., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë PKR.nr. 392/2015 të datës 29.06.2016, vetëm përkitazi me vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin S.G. , për veprën penale për të cilën është shpallur për shkak të veprës penale, Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 135 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 11(njëmbëdhjetë) vjet, në dënimin me burgim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.12.2014, e tutje.

2. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë, PKR.nr. 392/2015 të datës 29.06.2016, i akuzuari S.G. , është shpallur fajtor për veprën penale, Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, nga neni 144 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 135 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së, dhe është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 13(trembëdhjetë) vite, në të cilin dënim i është

llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.12.2014 e tutje, konfrom nenit 62 par.2 nënpar.2.7 dhe nenit 69 të KPRK-së, të njëjtit i është shqiptuar dënim plotësueses me të cilin konfiskohet vetura “ Renault Clio“ me tabela regjistrimi BG..., si mjet me të cilin është kryer vepra penale, si dhe i janë konfiskuar 23 pajisje të eksplozivit “ PETN “ me peshë totale prej 12.219 kg, si sendet të destinuar për kryerjen e veprës penale.

Është obliguar i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 300(treqind) euro, brenda afatit prej 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit në afat ligjor ankesë kanë paraqitur.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Zh. J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar të ndryshoj sa i për këtë kualifikimit juridik të veprës penale, të akuzuarit ti shqiptoj dënim me të butë ose lënda të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. D.V., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, shkeljes se ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar të ndryshoj sa i për këtë kualifikimit juridik të veprës penale, ose lëndën të kthehet në rivendosje.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.552/16 dt. 19.10.2016, ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPKR-së, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën prezantuan i akuzuari, mbrojtësi i të akuzuarit, av. Zh. J., ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori Apelit, av. D.V., të cilët kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, mendimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit dhe pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjen se:

Ankesat e mbrojtësve të akuzuarit janë pjesërisht të bazuara, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, kurse për bazat tjera nuk janë të bazuara.

Mbrojtësit e të akuzuarit pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që kanë të bëjnë me neni 384 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së, për faktin se gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësinë e provave, e veçanërisht ekzistimin e veprës penale për të cilën i akuzuar është shpallur fajtor, si dhe nuk i ka dhënë arsytet e mos miratimit të propozimit të mbrojtjes lidhur me

rikualifikimin e veprës penale në veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga nenit 372 të KPRK-së, se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar motivin, si element esencial dhe dashjen për kryerjen e veprës penale, se vepra penale mund të jetë kryer nga motivet e ndryshme, nga detyrimi, kërcënimi dhe nga rrethanat tjera që mund të kushtëzojnë një person në kryerjen e veprës penale. Se nuk është kontestuese se i akuzuari ka kontaktuar me ish pjesëtarin e policisë së Serbisë Zh.T. me të cilin ka pasur raporte shoqërore ka pranuar të transportoj për në Kosovë materie eksplozive, me qëllim të fitoj para për pagesën që kishte me kryer në emër të kredisë dhe borxhit që e ka pasur, kurse gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar qëllimin dhe dashjen e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësi të akuzuarit, nuk qëndrojnë, aktgjykimin e ankimuar nuk përmban shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as që ka shkelje tjera esenciale të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e që kishin me ndikuar në ndryshimin e aktgjykimit dhe rikualifikimin e veprës penale. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni me dispozitat e nenit 370 par.7, të KPPK-së. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara.

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të veçantë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe ka paraqitur arsyet e mjaftueshme se pse konsideron se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilën e ka shpallur fajtor. Sepse i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka pranuar veprimet inkriminuese, se materien eksplozive e ka pasur në posedim dhjetë ditë para ardhjes së tij në Kosovë, se tri here e ka kaluar nëpër piken kufitare pa iu kontrolluar vetuar me të cilën ka bartur materien, sipas të akuzuarit marrëveshja ka qenë që ai të vendoset në "Hotel NN" dhe të pret veprimet sipas urdhrave, ashtu që dy herë është vendosur në "Hotelin NN" ndërsa herën e tret deri është kapur nga policia në Dragodan. Ashtu që në këtë rast ka ekzistuar dashja e të akuzuarit dhe këmbëngulësia e tij që të kryej veprën penale, kurse nuk është vërtetuar me asnjë provë se ka qenë i detyruar dhe ka pasur kërcënim për të vepruar i akuzuari siç pretendon mbrojtja, se gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsye të mjaftueshme në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Duke u bazuar në raportin mbi ekzaminimin e eksplozivit i përpiluar nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI) në ShBA dhe Raporti i policisë së Kosovës për trajtimin e mjeteve eksplozive, ku është vërtetuar se janë gjetur 23 paketime të materieve eksplozive (PETN) me fuqi shpërthimi 8.400 m për sekondë, të cilin eksploziv e përdorin forcat ushtarake për prodhimin e minave dhe granatave. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2 dhe nenit 370 par. 7 të KPP-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose si të pa provuara, ashtu që ka bërë analizën e të gjitha provave të administruara dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë.

Mbrojtësit e të akuzuarit pretendojnë se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e ligjit penal kur të akuzuarin e ka shpallur fajtorë, për veprën penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.3 lidhur par.1 dhe neni 135 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së, sepse në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale importi eksporti, furnizimi transportimit, prodhimi, këmbimi dhe ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 të KPRK-së .

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata e Shkallës së Parë drejtë ka zbatuar ligjin penal, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.3 lidhur par.1 dhe neni 135 par. 1 pika 1.9 të KPRK-së, për të cilën e ka shpallur fajtorë të akuzuarin S.G. , ndërsa pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale importi eksporti, furnizimi transportimit, prodhimi, këmbimi dhe ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 të KPRK-së, janë të pa bazuara, meqë i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pranuar se materiet pëlcitëse i ka sjellur në Kosovë dhe atë tri herë me çka është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë fajësia e të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Mbrojtësit e të akuzuarit përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike e kontestojnë mënyrën se si janë vlerësuar provat e administrimit gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe konkludimet të cilat i ka nxjerrë ajo në bazë të provave. I akuzuari me sasinë e eksplozivit ka kaluar pikat e kontrollit kufitar pa pengesë tri herë deri sa është lajmëruar policia e Kosovës nga vetë personi i cili ia kishte dhënë mjetet eksplozive Zh.T., ashtu që i akuzuari në këtë rast ka qenë viktimë sepse është vënë në lajthim me mirësjelljen e tij, duke i shkaktuar vetit edhe dëme materiale, duke i besuar personit të gabuar ka pranuar rolin e transportuesit në të njëjtin rast ka gabuar edhe kur Zh.T. ia ka huazuar një sasi të hollash dhe nga kjo pozitë e tij ka pranuar kërkesën që të transportoj eksplozivin ose për ndryshe ka qenë i detyruara që të bëjë vetëvrasje. Duke pasur parasysh gjendjen e tij psikike në të cilën ka ardhur nga frika dhe pasojat që të mbuloj humbjet e mjeteve të cilat i kishte si udhëheqës i rendit shtëpiak si dhe kreditin të cilin e kishte huazuar e vetmja zgjidhje e tij ka qenë që të pranoj ofertën edhe nëse përballë me rrezikun, ka menduar se lehtë do të përballoj të gjitha sfidat dhe të arrij të dorëzoj eksplozivin sipas porosisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit lidhur me gjendjen faktike nuk janë të bazuara, ngase gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit, është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit M.R. i cili është dëgjuar në cilësinë e ekspertit për eksplozive, nga raporti mbi ekzaminimin e eksplozivit i përpiluar nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI) në ShBA dhe Raporti i policisë se Kosovës për trajtimin e mjeteve eksplozive, ku është vërtetuar se janë gjetur 23 paketime të materieve eksplozive (PETN) me fuqi shpërthimi 8.400 m për sekondë, të cilin eksploziv e përdorin forcat ushtarake për prodhimin e minave dhe

granatave, se i akuzuari .me datën 25.12.2014 me veturën e tij të tipit Renault Klio me tabela të regjistrimit BG-..., rreth orës 21:00 në lagjen Arbëria në Prishtinë është ndaluar nga Policia e Kosovës, ku pas kontrollimit të bagazhit në veturën e tij është gjetur çanta me eksploziv, me 23 pajisje eksplozivi me peshë 12.2019 kg i cili përmban eksploziv të fuqishëm Pentaerytritol Tetranitran (PETN) i kombinuar me fragmente metali bulona dhe gozhda të cilat shërbejnë për rritjen e fuqisë shkatërruese dhe shkaktimin sa më të madhe të viktimave në njerëz dhe dëme materiale, të cilat kanë qenë të paketuara në qese të plastikës të cilin fakt nuk e ka kundërshtuar as i akuzuari, i cili ka pranuar se materien eksplozive e cila është gjetur në veturën e tij e ka pasur në posedim dhjetë ditë para ardhjes së tij në Kosovë, ja ka sjellur miku i tij ZH.T.. Nuk e ka mohuar faktin se edhe dy herë para ditës kritike ka ardhur në Prishtinë është vendosur në Hotel Grand, mirëpo nuk janë paraqitur personat të cilët i kishte thënë ZH.T. se do ti takoj. I akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se është duke bartur materie të rrezikshme eksplozive, se ka qenë i dedikuar për shkatërrimin e njerëzve dhe objekteve, ka pasur njohuri se eksplozivi aktivizohet përmes telefonit rrymës dhe në mënyra tjera. Sipas të akuzuarit arsyeja që është përfshirë në këtë veprë penale, ka qenë gjendja e dobët ekonomike, borxhi që e kishte, por edhe fitimi material. Ashtu nga të gjitha këto që u thanë më lartë është vërtetuar se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte me paramendim dhe duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tij, tri herë brenda 5 ditëve ka hyrë në territorin e Kosovës duke bartur në veturë materien eksplozive.

Të gjitha këto sipas gjykatës së Apelit janë prova bindëse se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, se pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit lidhur me këtë bazë nuk janë të bazuara.

Mbrojtësit e të akuzuarit në ankesë pretendojnë se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i ashpër për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ka qenë e ndikuar nga rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe për këtë i ka shqiptuar maksimumin e dënimit prej 4/5 për këtë veprë penale, por duke pasur parasysh gjendjen e tij familjare, se është i martuar, nuk ka të kaluar kriminale, sjelljet e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, se i është ekspozuar një rreziku të madh duke i besuar shokut të tij T., ashtu që Gjukata e Shkallës së Parë i ka përmendur rrethanat lehtësuese pa i vlerësuar ato se i akuzuari qysh në procedurën paraprake i ka pranuar veprimet inkriminuese por jo edhe kualifikimin juridik të veprës penale.

Gjukata e Shkallës së Parë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë, në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh, se i akuzuari është familjar, baba i dy fëmijëve të mitur, i gjendjes dobët ekonomike dhe sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, kurse si rrethanë rënduese gjykata ka marrë për bazë mënyrën e kryerjes së veprës penale, këmbëngulësin dhe vendosmërinë për kryerjen e veprës penale intensitetin e lartë të rrezikimit të vlerave të mbrojtura, siç është jeta e njeriut.

Vlerësimet e këtylla të rrethanave relevante për matjen e dënimit, i pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në pranimin e rrethanave lehtësuese të aplikuara nga gjykata e shkallës së parë, ka vend për shqiptimin e

dënimin më të butë, duke pasur parasysh faktin se i akuzuari me pranimin e veprimeve inkriminuese, ka kuptuar pasojat e veprimit të tij. Prandaj duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret kontiunitetin e veprimtarisë inkriminuese të të akzuarit, del se dënimi i shqiptuar si në dispozitivit të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akzuarit, është në funksion të preventives gjenerale dhe të asaj individuale, se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozita të nenit 41 të KPRK-së.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 403 të KPPK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.591/16 dt.15.11.2016

Procesmbajtësja:

Rrezarta Lleshaj

Anëtarët e kolegjit:

Have Halitit

Driton Muharremi

Kryetari i kolegjit:

Xhevdet Abazi